



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:214535
Datë: 11.07.2024
Numri i dokumentit: 05929201

Ac.nr.688/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit A.P nga Klina rruga “....” nr., kundër të paditurës Qeveria e Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, Komisioni i Ankesave Shpërblimeve, në Prishtinë e përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Çështje Ligjore, të cilën e përfaqëson Nazmie Aliu me autorizim, me objekt kontesti anulim i vendimit, duke vendosur në lidhje me ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1266/15, i datës 17.10.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e paditësit, A.P nga Klina rruga “....” nr., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1266/15, i datës 17.10.2019, PRISHET dhe çështja i kthehet në procedim të serishëm të njëjtës gjykatë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1266/15, i datës 17.10.2019 ka vendosur si në vijim:

“I.REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit A.P nga Prishtina me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm vendimi i komisionit për Ankesa dhe Shpërblime i Policisë së Kosovës me nr.064-KA-D/2015 dhe ti kthehet pozicioni në të cilin ishte më parë si dhe ti rikthehet ndalesa prej 25% nga paga bruto si E PA BAZUAR

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.”

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur paditësi, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe gjykata ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje të serishme.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi me datën 01.06.2015, ka paraqitur padi, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës në Prishtinë, me objekt të padisë kontest pune anulimin e vendimit, më konkretisht me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1266/15, i datës 17.10.2019 me të cilin është refuzuar kërkesëpadija e paditësit duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se pas vlerësimit të provave të administruara në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi ishte i punësuar tek e paditura me detyrë polic në Drejtorinë Rajonale të policisë në Republikën e Kosovës, por kontestuese sipas Gjykatës së shkallës së parë ishte fakti se me 16.01.2012 toger A.P –paditësi kishte asistuar Kforin Zviceran që automjetin e tipit Audi A8 që ishte pronë e qytetares A.SH ta dërgonin në Njësinë e Komunikacionit Rrugor në Pejë me qëllim që ti bëhet verifikimi pasi që Kfori Zviceran ishte në dyshim për të mos ishte e vjedhur, andaj mes palëve ndërgjyqëse ka qenë kontestuese se paditësi A.P a kishte dështuar në kryerje të detyrave në marrjen e veprimeve zyrtare policore, a është dashur ta liroj automjetin në fjalë pasi që është dyshuar se ka qenë i vjedhur.

Tutje në arsyetim ka shtuar se Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se shkeljet e pretenduara nga e paditura qëndrojnë pasi që në rastin konkret paditësi ka bërë shkelje disiplinore nga kreu II, neni 5 pika 5 dhe neni 9 pika 1 dhe 8 të UA nr.15/2008 lidhur me nenin 47 pika e të Ligjit për Policinë, duke shtuar se ka analizuar dosjen e hetimit dhe ka gjetur se automjeti i lartcekur kishte targa jo të rregullta të shtetit zviceran dhe të njëjtën veturë paditësi e kishte liruar pa iu nënshtruar procedurave doganore, e këtë e kanë dëshmuar edhe zyrtarët doganor. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se vetura ka qenë në emër të dikujt tjetër e jo pronë e qytetares A.SH andaj nuk ka pas të drejtë ta merrte dikush tjetër përveç pronarit, e paditësi çelësat e veturës ia kishte dorëzuar qytetares pa plotësuar formularin e pranimit-dorëzimit ashtu siç kërkohet me parimet e standardeve të Operimit, udhëzimet si dhe ligjet në fuqi lidhur me konfiskimin dhe kthimin e automjetit të pronarit, e po ashtu paditësi ka parkuar veturën në parking ë ka qenë pronë

shoqërore dhe jo parking pronë e policisë bazuar në planin dhe Politikën e Sigurisë së Objekteve Policore që ishte përgatitur nga Njësia Mbështetëse Operative në Pejë.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka marrë konform nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 lidhur me nenin 160 të LPK-së, gjendja faktike nuk është vërtetuar në tërësi si rezultat i të cilave e drejta materiale është zbatuar gabimisht.

Aktgjykimi i atakuar si i tillë nuk është në përputhje të plotë me kërkesat nga neni 160 paragrafi 4 dhe 5 të cilat përcaktojnë: “ 160.4 Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato. 160.5 Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohej edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor.” Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të saj ka përshtuar thëniet e palëve gjatë seancave të mbajtura, po ashtu vetëm ka përshtuar provat të cilat i ka marrë për bazë me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, mirëpo këto prova nuk janë të arsyetuara më konkretisht nuk mund të kuptohet se çka ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë me anë të provave dhe si i ka vlerësuar të njëjtat, poashtu, në raport me faktet vendimtare sidomos fakteve që i referohen vlerësimit të afatshmërisë së procedurës disiplinore, arsyetimi i gjykatës është i mangët dhe i ngatërruar e që si i tillë nuk është i plotë dhe i qartë.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret kemi edhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për arsye se nuk janë vërtetuar në tërësi të gjitha faktet vendimtare me rëndësi në çështjen konkrete, pasi që Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye konkrete se në çka saktësisht konsiston dështimi i paditësi në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi të caktuara të cilat kanë shkaktuar apo kanë mundur të shkaktojnë efekte negative në reputacionin e Policisë dhe në efikasitetin e kryerjes së detyrave, siç parashihet me nenin 9 pika 1 e Ligjit për Policinë, i cili nen është zbatuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit është dështuar që të saktësohet se cilat veprime konkrete është dashur që ti merr paditësi në rastin të cilin ka qenë duke e hetuar, a janë ndërmarrë këto veprime e nëse po a janë ndërmarrë në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e paditësit.

Po ashtu, paditësi vazhdimisht gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore është thirrur në faktin se e paditura nuk e ka zhvilluar procedurën disiplinore brenda afatit të paraparë me Udhëzimin Administrativ, UA.nr.06/2012, por Gjykata e shkallës së parë e ka injoruar në tërësi këtë pretendim duke mos dhënë as edhe një arsye të vetme se a është zhvilluar procedura disiplinore brenda afatit kohor të paraparë me Udhëzimin Administrativ.

Neni 66 i Udhëzimit Administrativ, nr.06/2012 përcakton se: *“1.Paneli disiplinor dhe i ankesave duhet të përfundojë me procedurat disiplinore dhe të shqyrtimit të ankesave brenda 30 ditësh, nga dita e paraqitjes së rekomandimit nga DSP-ja, niveli lokal apo nga data e pranimit të ankesës. 2.Mos përmbajtja e këtij afati mund të bëhet vetëm për shkak të krijimit të situatave – rrethanave të jashtëzakonshme dhe rasteve të veçanta/emergjente.”*

Si rezultat i shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të mangët dhe jo të drejtë të gjendjes faktike kemi edhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Në rigjykim gjykata duhet të eliminojë shkeljet dhe të metat që e kanë shoqëruar aktgjykimin e atakuar, dhe pas ndërmarrjes së veprimeve të tilla, të vlerësojë edhe njëherë afatshmërinë e procedurës disiplinore dhe ligjshmërinë e vendimeve që janë marrë brenda kësaj procedure, ku pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të bie vendim meritor, i cili vendim duhet të jetë në përputhshmëri të plotë me kërkesat nga neni 160 i LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.688/2021, me datë 04.07.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.